Digiuno *aggett.* esulli, përesulli, njinueshimi, i orgjërueshimi; *di quadragesima* njinesa e katerdhjetçime.

Dignità nderia; të madhëtë, madhia f.

Di grazia lutem, vare.

Di là andi, *di là oltra* të, *di quà* këndi.

[54] [— për]

[55] \di giorno in giorno adv. ððita për ððita/

Dileguare shprish.

Diletto, piacere lodra, kënaqja; pëlqimi.

Dilettare përkënaq -aqurë -aqem; pëlqenj.

Dilettevole i pëlqieshimi.

Diletto, amato i dashuri, e dashura.

Diligente i kujdeshimi; i vëjershimi *ingegnoso.*

Diligenza kujdesa, kujdesi m.

Di së, *di lontano* së largu.

Di mala voglia pā hur, me zī.

Dimenticare harronj -uarë -onem.

Dimenticanza të harruamitë n.

Diminuire mbak -akurë -akem; vogëlonj; pakonj; naçent -enturë -entem.

Dimora mënesa, mënimi m.

Dimorare mënonj; varonj; ndalem, u ndala, ndalurë *da* dalë.

Dimoratore, tordo varuesi.

Di nuovo së riu, për së riu; *la seconda volta* së dīti; *sic.* pameta.

Dio Hī -it m. *Dio eterno* Hī ëmeshuemi.

Di poi, per l'avvenire, in appresso mbasandej.

Diportarsi male keqësonj; *bene* e shkonj mirë.

Diportarsi a solazzo shetit -iturë -item.

Di quanto in quanto her e herë.

Di quà këndi.

Diradicare shkul -ulurë -ulem.

Diramare shkienj; shklienj -jeturë -ihem.

Dire thom, the ,thashë, thënë, thënërë, thuhem; flas, fola, folë, flitem *favellare.*

Diritto, in piè i nçuarë, ngrijturë; *adv.* mbarë.

Diritto, retto i drejt, e drejtë, të drejt.

Direttamente bukurë, mbarë *sic.* dreq.

Dirizione ndreq -equrë, ndreqem.

Diroccarsi, venir giù la parte di qualche collina shëmbem -ëmburë

da shëmb. *Luogo diroccato* shëmbja.

Dirupare rreronj -uarë -onem; rrezonj -uarë.

Disarmare nxier armëẗë; nxhesh armjet.

Discacciare udhonj -uarë -onem; përzẽ.

Discalzare zbadh -arurë -athem.

Discepolo gjakoni, xënësi, xërësi -it m.

Disciplina të thënëẗë n.

Discingere sngjesh -eshurë -eshem.

Discolpare lānj -ajta, larë, lahem.

Discordia kallaba f. davia f.

Discollare zbërthenj -ierë -enem; çkalmonj e skalmonj -uarë -onem.

Disconvenire ska hẽ, skam hẽ.

Discorrere ligjëronj -uarë -onem.

Discorso, trattato ligjërata f.

Discorso gjikimi *sic.*

Discrezione, riguardo njerezia.

Discutere përthānj -ajturë -ahem.

Disegno, modello mendira f. *Disegnare e lineare.*

Disfare çortinj -arturë -artem.

Disfarsi, dileguarsi shkrinj -ijturë -ihem.

Disertare *delle donne* dërstonj; *delle bestie* shtje -ura, shtënë[56], shtihem.

Disfibbiare, slacciare zbërtenj -ierë -enem.

Disgiungere ndānj -ajturë -ahem.

Disgrazia fatëkeqi e keqa f. *Disaventura.*

Disgrazia, odio menia f.

Disgustare idheronj -uarë -nem.

Disonesto i dhënuami, i dhënueshimi.

Disonestà dhuna e dhunia f.

Disonestamente dhunisit *sic.* horjasisht

[56] | -- stë|

Disonorare dhuni -it m. dhunia f.

Dislattare hjek gjitë.

Disleale i pāfeu m.

Dislocare zdredh -edhurë -idhem.

Disintricare shkaterronj -uarë -onem.

Dismembrare shqierr -jerrë -irrem.

Di sopra përsipër.

Disordinare trazonj -uarë -onem.

Disordine të pāudhëtë.

Di sotto ndënë, ntënë; *il di sotto* i përposhmi.

Disparte ndāshim, ndarë.

Dispenza, riposo qori -it m

Dispenza del superiore ndjesa f.

Dispenzare ndienj -ierë -enem.

Dispenziero qoresi -it m.

Dispettoso pishmatari -it m.

Dispetto pishmatia f. bënj për pishmati *far dispetto.*

Disponere, ordinare urdheronj; godit, ngreh, ngrehurë, ngrehem.

Dispreggiare për këmb -ëmburë -ëmbem; ndë përkëmp, përkëmp.

Dispreggio çminjeria f.

Disputa shkirëtimi m. shkiretima f.

Disputare shkiretonj, ligjeronj -onem.

Disputatore shkiretuesi -it m.

Dissipare cosa liquida derdh, përderdh; *cose solide* çartinj, shprish.

Dissipatore përderdhesi, ndretesi, çartesi m.

Dissuadere sëval -alurë -alem.

Distaccare këput, këpunj; ndanj.

Distaccamento të këputuritë; të ndārtë n.

Distanza të llargëtë n.

Distante llargu m. llarga f.

Distendere panni etc. ndēnj -ejturë -enem.; shtronj; latit, latitinj -iterë.

Distendere sottilmente come lame, ferro shtrīnj -ijturë -ihem.

Distinguere ndānj -ajturë, ndārë -ahem.

Distintamente ndāshim, mbosë.

Distinto i mbosi, e mbosa; i ndajturi.

Distinzione të mbosëtë n.

Distrecciare sples, spleks -eksurë -eksem.

Distribuire ndānj.

Distruggere çartinj, shprish, shkretëtonj, rreronj; *sic.* rëronj përmis.

Distruggitore nçortesi.

Distruzzione rrerimi.

Disturbare mshonj -uarë -onem; urrēnj[57] -icjturë -ejturë, urrehem.

Disubidiente i pāgjegjëshimi.

Disubidienza të pāgjegjuritë.

Di subito një ças, ndë ças *in un momento.*

Disunire ndānj; të ndāmitë *disunione.*

Di tutto il cuore gjith zëmërjet.

Diventare dal, dolla, dalë; bëhem, bënj.

Diversamente ndrishei o ntrishei.

Dividere mbos, mbosinj. *Vedi distinguere.*

Divinamente pushtueshim; hījnueshim.

Divinità hjenia f.

Divino hienueshimi, hienueshimcja f.

Divisibile i ndāshimi.

Divolgare përpall -allurë -allem.

Divolgamento të përpalluritë n.

Divorare përpīnj -ijturë -ihem.

Divoratore përpīsi.

Divozione të dashuritë, të prunjëtë n.

Documento mbsimi.

Docile i mbsuesrimi.

Dodeci dīmbëdhjetë.

Dogana zarina f.

Doglia të dhëmburitë.

Doglioso i dhëmbshimi, *i* dhëmbtëshimi.

Doi di, *a due a due* di nka di.

[57] |urregn|

Dolce i ëmbli, e ëmbla, të ëmblitë.

Dolcemente me të ëmble.

Dolcezza t'ëmblitë *sic.* ëmlbësi, ëmblësira[58].

Dolersi dhëmbem *da* dhemp -emburë.

Domane nesërë, *di domane* i nesërshëmi; *postdomane* mbasnesërë, dej[59].

Domanda të pieritë, të lipuritë.

Domandare lip, pienj.

Domandatore lipsi.

Domare zbut, zbutsonj, zbutinj -urë -utem.

Domatore zbutesi.

Domenica e diellja f.

Domesticare zbutësonj.

Domestico i buti, e buta, të butëtë.

Domestichezza të butëtë.

Dominare zotronj -uarë -onem; pushtonj.

Dominante zotrori, zotresha; pushotri, pushtuesi *meglio.*

Donare dhuronj -uarë -onem; fal -alurë -alem.

Dono dhurimi *sic.* të falëtë, të faluratë.

Donde kaha.

Donna grua, gruaja f.

Donna di porto lehona f.

Donnescamente grārisht.

Donnesco grāruesi.

Donnola bukëla f.

Donzella vajza, *sic. anche* vashë pl. vashatë.

Doppo ani mbas, mbasandej, mbasi, pā, prā, pas, pastaj.

Doppocché posa, posā.

Doppio dī faqi, dī zëmëri. *Giano.*

Doppio dīfijë.

Dormiglioso flësi.

Dormire flë, fjeturë, fjeta.

Dorso kurrizi.

Dote paja f.

Dotto, savio djesi, i ditshimi, i mbsuemi.

Dottamente ditshim; *dottore* mbsuesi.

Dottrina mbsimi, dicja f.

[58] /ëmbëlsira\ [59] /dɛχh\

Dove ku, tek, tuk ke.

Dovunque ke do, ku do.

Dragone kulshedra f. stihja f.

Dragonino, forte i drëngeti, i kulshendri.

Dramma drehemi.

Drappo coha f. *Di panno sic.* i coht.

Dubbio të ndërdimëtë, ndërdimi.

Dubbioso ndërdemeri.

Dubbiosamente ndërdīshim.

Dubitare druc, drashurë, druanj. *Esser dubbioso* ndërdihem -ierë.

Duca duka, zoti i madh, *principe* zot.

Dunque prā, pra.

Durare rronj -uarë; *perseverare* duronj.

Durare, indurire thanj -ajturë -ahem.

Durare, persistere, sopportare sheferonj -ierë; pesonj.

Durazione rresa f.

Divenir duro thahem, ngurohem, gurohem -uarë *da* guronj.

Durezza të guruamitë; të thātitë n.

E

E, et e; è *verbo* ësht, isht, ë.

Ebro i demi, i shendëmi, pijsi.

Eccellente i madhi, e madhja, të madhëtë.

Eccellenza të madhëtë, madhia f.

Eccessivamente pā kuer.

Eccessivo i pākuershimi, i pākori, i pāskorri.

Eccetto jashtë.

Eccettuare ndānj.

Eccitare ndërsenj -ierë - onem.

Eclisse të marrëtë.

Ecco gje, nje, ënje.

Effeminare grāronj -uarë - onem.

Effetto puna f. *in effetto* ndorë.

Effettuare ndorinj -orurë - orem, mbaronj.

Efficacia pushtetja, *efficace* i pushtueshimi.

Effigiare shëmellonj -ierë, shemelonem.

Effigie shemelletira.

Egitto misiri; *l'egitto* misirasi, magjipesi, magjipi; *l'egitto pure.*

Egli ai, ajo, ata; *egli stesso* ai vetë.

Eguale i njëmendi.

Elefante fili -it m.

Elegante i pëlqieshimi, i bukuri.

Elegantemente bukurisht, pëlqieshim.

Eleggere zgjedh -edhurë - idhem.

Elezione të zgjedhuritë n.

Elemento limenti.

Elettore zgjedhesi.

Elevare lartsonj -uarë -onem; ngreh, ngrehinj -ijturë *da* ngrihinj.

Ellera urdhi -it m.

Elmetto tulga f.

Eloquente gluhtari.

Eloquenza gluhtaria; *meglio* gluhëzia f.

Emendare ndiskonj -uar -onem; dërtonj.

Emendazione ndiskimi -it m.

Emolare zalesinj -esurë.

Emolazione zali m.

Emolo zëlshimi.

Empietà mizira.

Empio i përmëkatëruemi; i shtrëmëri.

Empire mblonj -uarë, mblot, mblonem; mbush -ushurë -ushem.

Entrare hīnj -ijturë -ihem.

Entrata hima f.

Entro brënda, përbrënda.

Epiro Arbri, Arbria.

Epirota Arbreshi, Arbrori, Arbri.

Equità të gjīqitë n.

Errare fajenj -ajturë *sic.* sfal -alurë. *Andar errando* shetit, shetitinj -ituë -item

Errore fajca, *sic.* sfalma.

Errare, sbagliare harronj.

Esalare avullonj -uarë -onem.

Esalazione avullim avulla pl.

Esclamare bertes, brita, briturë.

Escludere nxier jashta, përziell, nxjerre perziellë.

Escusare lānj -ajturë, lahem.

Esistenza të mbeturitëtë, të klënëtë n.

Esordio të zënëte, të zënëte fill.

Esperimentare kërkonj -uarë -onem.

Esperimento kërkimi.

Essaltare lartëzonj -uarë -onem.

Essaltazione të lartëzuemitë n. të quemitë.

Essaminare skiretonj -uarë -onem.

Esaminatore skiretuesi.

Essamina skiretimi.

Essaudire gjegjem[60] -egjurë.

Esseguire il comando shërbenj -ierë.

Essempio[61] shembelltira f. shembua f.[62].

Essenza të klënëtë.

Essercizio shërbëtira.

Essercitarsi shërbenj.

Essercito ushtëria f.

Essere jam, kleva, klënë.

Essistere jam, jes, mbeta, mbeturë.

Esso ai, ajo, ata.

Essorcizare përbënj -ejturë -enem.

Essorcismo të përbëmite.

Essorcista përbësi.

Essortare, indurre prinj -ijturë e prierë.

Esta|te| vera f.

Esteriore i përjashimi.

Estinguere shuanj -uarë -uhem; skimbinj -imburë -imbem; fikinj -iturë, fikem.

Estirpare shkul -ulurë -ulem; shfundonj -uarë -onem e çfundonj.

Estirpare erbe cattive shkul, hërinj, hërurë, hërem; rruanj -uajturë -uhem.

Estraere ngreh -churë -chem.

Estremità skanji -it m.

Estremo i mbraperi, i mbrëmi.

Estrinseco, esterno i përjashtimi.

Estrinsecamente, esteriormente prëjashta.

Estro, specie di mosca zehthi -it m.ë

Essultare gëzonem, gazonem -uarë *da* gazonj, *da* gazi.

Età moti m. *di molta età* i motçimi e korrute i motçimi.

Età matura moti i pjekurë.

[60] |gh-h| ghieghiem [61] |— vestigio| [62] /scembua\

Età decrepita pleqëria e mbeturë.

Eternità ameshimi, jeta e ameshuemeja; e pāsosme.

Eternare ameshonj -uarë -onem.

Evacuare mbraz -azurë -azem.

Evangelio ungjilli -it m. *cioè* ungjilli *ed* ungjelli.

Eunuco i dredhuri, kadumi -it m.

F

Fabro di legni lëndetari, pelekani.

Facchino porta robba ai çë mbān barrënë.

Faccia faqeja, fitira.

Facenda e bëmeja f. zira f.

Facezia, burla gumezia.

Faceto, burlevole gazetari, i pëlqieshimi.

Facile udobi, e udoba, të udobëtë.

Facilmente udob, kolaj.

Facilità të udobëtë n.

Facoltà, poderi të pasuritë; bëgatia; gjëeja f.

Fagiuolo, legume llathiri -it m. *sic.* llathuria f.

Falce da segare i prati kosa f.

Falcetta, ronciglio qeza f.

Falce damieter le biade draperi m.

Falciare il fieno kosit -iturë -item.

Falcone uccello skifteri m. gjerakina *la femina.*

Fallacia ngenjmi m.

Falciatore kositesi *sic.* korsi pl. korsetë.

Falsamente rremëshim, rreneshim; shtrëmërueshim.

Falsificare palavonj -uarë -onem.

Falso, bugiardo rrenesi, rremsi, rreshimi, rremi.

Falsificato come moneta kalpi -it m.

Fama zëri -it m. fjala f.

Fame uri -it m. uria f. ūi m.

Famelico i urëshimi.

Famoso i lëvduami.

Fanciullo djali m. femija f. *l'ancinlla* vajza f.

Fanciullezza *de'maschi* djelmëria; *delle femine* vajzeria; femijeria.

Fanciullescamente djalisht; vajzërisht.

Fango bajta f. bajti m. *Di fango* baltjet;

Fangoso përbajtshimi.

Fantasia, bizarria këmbenjeria f.

Fantasma hjeja f. ëndërra f.

Fantastico, apparenti i dukshimi.

Fantastico, furioso, bizarro i këmbjemi, kriekurziemi m.

Fante, soldato pedone sejmeni, këmbsi m.

Fantesca shërbëtoreja f.

Fardello, fagotto di robbe trëmba f.

Fardello di lino skulidheja f.

Fare bënj, -ërë, -ënem.

Fare amicizia miqëronj -uarë -onem; pajtonj.

Fare a pugni grushtonj -uarë -onem.

Far bianco bardhonj, zbardh.

Fare collazione sëllonj -uarë -onem.

Far dispetto pismatis -isurë -isem.

Fare esequie spal.

Far le frondi ngjethonj -uarë -onem.

Far il grande madhonem *da* madh.

Far la sentinella përgjonj -uarë; ruanj.

Far ingiustizia gjikonj shtrëmërë.

Far la lotta mirrem përbaltazë.

Far il mezzano tregetonj -uarë -onem.

Far odore bënj e bie erë.

Far pace mbaqem -aqurë *da* mbaq.

Far il pane gjesh -eshurë -eshem.

Far piacere bënj hīr.

Far robusto butreronj -uarë -onem.

Far testamento bënj dhjatë.

Far la tigna bënj kerosë.

Far vermi krimp -imburë, krimbem.

Far viaggio per mare, navigare vizit -iturë -item; vuanj detinë.

Farsi livido ireronem -uarë -onem, *da* ireronj.

Farsi giallo verdhem -erdhurë, *da* verdh.

Farsi pallido zbehem, zbërë, *da* zbënj.

Farsi stupido il membro zbihem -ejturë *da* zbinj.

Faretra kukura f.

Farfalla flutërza f.

Farina miellëtë n. *fior di farina* maja e miellitë. *farina bollita* qulli.

Farneticare hutonj -uarë -onem.

Farnetico i hutuami.

Fascello d'api kuveli -it m. *sic.* kuvelja, zgjoi m.

Fascello d'ape novella bletëza f.

Fascia d'uomini çençeleja f. *di bambino* sporgari.

Fasciare njesh -eshurë -eshem.

Fascio dhomati; barra f.

Fascetto di spighe çistreja f.

Fastidire mshonj -onem; urrënj. *esser in fastidio* merzitem, merzitur *da* merzit.

Fastidio mshimi m. urrieshimi m.

Fastidioso i merzitshimi; i urrieshimi.

Fasto, pompa skima f.

Fastoso skimatari -it m.

Fatica fadiga; *meglio* shërbëtira *sic.*

Faticare fetkonj; *meglio* shërbenj *sic.*

Faticoso fëdigetari, fetkuesi *sic.* shërbëtori, i shërbuemi.

Fato, sorte, destino e bëmja f.

Fattore bësi -it m.

Fattura zënati -it m.

Fava batha f.

Favella di parlare të folëtë.

Favilla shkëndija f.

Favo di miele hualli -it m.

Favola perralla f.

Favolosamente perrallëshim.

Favoloso perrallishimi.

Favoleggiare thom perralle; *inventor di favole* perrallesi -it m.

Favore ndihma, ntihma f. *sic.* hīr.

Favorevole ndihmetari.

Favorire ndih -ihurë -ihem, ndihmonj.

Fazzoletto lungo pashemalli, pashtemalli, semantili.

Fazzoletto che portano in collo li bravi vizeja f.

Fabraro frueri m.

Febbre etha f.

Feccia, lordura bersia, brëmi m.

Fecondare mbars -arsurë -arsem; frujtonj.

Fecondità frujti, mbarsa.

Fecondo i mbarsimi.

Fede, credenza besa f.

Fede di religione feja; *senza fede* i pāfeu

Fedele nelle parole besniku -ut m.

Fedele di religione i fēshimi.

Fedeltà me besë, fēshim.

Fegato mëlshia f.

Felice erba thieria f. *filicicchia.*

Felice fatosi, i lumi, i lumëti.

Felicità fatimirë, lumëria f.

Femina femera, grueja f.

Feminilmente grārisht.

Fendere çanj -arë -ajturë -ahem; ndanj; pres -erë, pritem.

Fenestra ballkoi -it m.

Fenile pleviza f.

Ferie ditëtë e levrueme.

Ferire lavos -osurë -onem; përgjeg -egjurë -egjem; plagonj.

Ferita lavoma f. plaga f.

Ferla kokuta f.

Fermare, trattenere ndal -alurë -alem *sic.* mbanj; *fermarsi in un luogo* jes.

Fermarsi qëndronj -uarë -onem.

Fermento të brumitë, brumëtë *sic.* brumë të thārtë, brumë të ngridhurë.

Fermentare mbrum -umurë -umem.

Fermentazione të brumitë.

Feroce i idhurë, i egri *sic. pure* i frosmi.

Ferocità egrësia f. t'idhuritë.

Ferrajuolo losniku -ut m.

Ferrare il cavallo forkonj -uarë -onem.

Ferro di cavallo petkoi -it m.

Ferro hekuri; *di ferro* hekurimi.

Fertile i ploti.

Fervido i nxëti, insëti.

Fervore vëla, vala, vrapa f.

Fessura di porta brimeza f. të plasuritë.

Festa e krëmtja, ditë e krëmte *festivo dì.*

Festuca limishteja *sic.* dushku, pl. dushqetë.

Fetido i qelbeti, i qelburi, i ndimi.

Fetore, puzza qelbesira.

Fetta thela f. *fettare* thelonj -uarë -onem.

Fettuccia di seta flufuraka f.

Feudo meracja f.

Fiacco i ligu; *fiacchezza* të ligëtë n.

Fiamma flaka f.

Fiammeggiare flakonj -uarë -onem.

Fianco ija -së f.

Fiasco buciela f.

Fiata hera f. heri m.

Fiatare frinj -ijturë -ihem.

Fiato frima f.

Fibbia di veste, scarpe etc. kopësa f.

Fibbia di porta, anello unaza.

Fica pithi m.

Ficcare ngul -ulurë -ulem.

Fico fiku -ut m. *Immaturo* briskalli m.

Fidarsi usdatem, usdaturë.

Fidato, securo usdaçimi, usdatshimi.

Fiducia, fidanza usdatia f.

Fiele helmi m. t'ëmblethitë, t'ëmblethitë, t'izuritë.

Fieno sanoi -it m. sanua, sona f.

Fiera, bestia selvatica bisha f.

Fiera di mercato tragetia f. tregu -ut.

Fierezza t'idhuritë, *crudeltà.*

Fiero i trëmbshimi, *crudele* i idhuri.

Figlio biri, *figlia* bilja e bija f.

Figliastro thjestri m. thjestra *figliastra.*

Figliolanza bileria f. e bjeria.

Figura, forma shëmbelletira f.

Figurare, ritratta shemellonj.

Figura, segno hjeja.

Figurativo i shëmëllieshimi.

Filare tier, tjerrë, tirem; *filato* të tjerritë.

Filo da cucire peu -ut m.

Filo filli -it m.

Filigine bloza f.

Finalmente ndë vore, mbasandej.

Filza di perle o coralli zerdheni o zerdhani, vargu -ut m.

Finale më i mbrëmi.

Fine të sosuritë, mbarimi.

Fino ndreq *sic.* njer; *fintanto* ndërsa.

Fingere bënj kinesë.

Fingersi, simulare stihem -ijturë e stim.

Finto i stijmi, e stijmeja, të stijmitë.

Finzione të stijmitë -it n.

Finire sos -osurë -osem; mbaronj.

Fino i kulluemi, e kulluemja, të kulluemitë.

Finocchio mërai -it m. *Di color di finocchio* i mërajmithi.

Fioccare, nevicare reshënj -eshurë -eshem.

Fiocco theku -ut m. natopi.

Fiocco di lana floku -ut m. floketë pl.

Fionda baeja *sic.* beja f.

Fiore luleja f.

Fiorire lulëzonj -uarë -onem.

Fior di latte kosi -it m.

Fischiare veshellenj -ierë *sic.* fushëkullonj.

Fischio veshellima *sic.* fushkullima f.

Fiumara, torrente perroi -it m.

Fiume lumi -it m.

Flagellare mshik, mshikinj, mshikurë, mshikem; rrah -ahur -ahem; rrihem.

Flagello, castigo sheplaka f.

Flagello intrecciato di funi litarëtë e dredhurë.

Flauto fieli -it m. skaruglë.

Flemma këlbaza.

Flammatico, pitruitoso këlbazshim.

Florido i lulëzuemi.

Fluido i rrjedhshimi, i kulluesshimi.

Flusso të rrjedhuritë.

Flusso e riflusso del mare batiza f.

Fluttuare lundronj.

Focile da buttar fuoco urori -it m.

Foce e canal dalla gola grika f.

Foco zjarri, *petra da buttar foco* strealli.

Focolare vatra f.

Focoso, foco lento i përziarshimi.

Fodero mili -it m. *di veste* sopani -it m

Foderar veste sopanos - osurë -osem.

Foggia, usanza zakoni -it m.

Foglia, fronde fleta f. gjethja f. *divenir frondoso* gjethonj -onem -uarë

Folgorare vetetonj -uarë - onem shrep -epurë.

Folgore vetetima f. rrëfeja f.

Folla, moltitudine shumica, tufa f.

Folle, pazzo i ndërruami, i këmbiemi, *sic.* i lëni; *follia* ndërrimi, këmbinjeria f. *sic* lënësia

Folto i briteti, e briteta, të britutë

Fomite të nxituritë.

Fondamento themelli m.

Fondamentale i themellituri.

Fondare themellitë -iturë - item, themellonj.

Fondo kthelli-it m. *profondo.*

Fondo fundi; *senza fondo* i pa fundi.

Fongo këpurdha f.

Fonte, fontana kroi, krou, gurra.

Forbice gërshara.

Forcina biga f. *forcetta da mani* bigëza

Forma fisica të qënëtë n.

Forma, modo udha f. *forma, aspetto* fitira f.

Formaggio djathëtë n.

Formare trajtonj -uarë -onem, mbukuronj -uarë -onem; *fabbricare sic.* stis -isurë -isem.

Formento grurëtë.

Formica melengona, deniegola f.

Formidabile i frikrueshimi *sic.* i frikrosmi, i frikruami.

Fornace furri, furra.

Fornaro furretari.

Fornicare kurveronj; *fornicazione* kurveria.

Fornicario kurvetari, kurva f.

Forse thomse, ndoshtë, ndonëse, bitë vall.

Forsennato krickërziemi, *sic.* i pātrū.

Forte d'animo trimi, zëmëruemi.

Forte fuqishmi, burretori m. burruresha f.

Fortemente trimërisht; *fortificare* forconj.

Fortezza fuqia; *di città* sogjia.

Forzare nxit -iturë -item; ngërmonj.

Fortunato fatosi, fatueshimi.

Fortuna fati, gjikata.

Forzatamente pa hīr, me zī.

Fosco i ziu, e zeza, të zīt.

Fossa gropa.

Fossa da sterco, munizzaru gropa plehit.

Fossare remonj -uarë -onem.

Fosso intorno ai campi hendaku -ut m.

Fra ndër.

Fraccassare thermonj -uarë -onem.

Fraccasso të thermuamitë.

Fracido kalbeti.

Fracidezza kalbesira f.

Fragile i kalbeshimi.

Frammento dromeza, derdhia f. derrëmiza.

Francia orlo della veste skundili, theku -ut.

Frappore qëndis -isurë -isem.

Fratellanza, fraternità vëllazeria[63] f.

Fratello vëllau m. *fraternamente* vellazërisht.

Fratta gardhi m.

Fraude, inganno gënjimi, njimdja, njimdimi.

Fraudato i gënjiemi, i njimtuami.

Fraudolente sherregjuesi.

Freddo i ftohti, e ftohta, të ftohtitë; *il freddo* të timëtë, të ftohtitë.

Freddo degl'ammalati ngjethuritë.

Fresco pane i njomi, e njoma.

Fressora, padella furtereja, tigani.

Fretta, prescia të nguturitë, hitja f. ngutureja, të shpejtëtë.

Frettoloso i ngutshimi; *frettolosamente* nguturisht.

Fringere fërgonj -uarë -onem; tiganis -isurë -istë -isem.

Frivolo i mbrazëti.

Freddura, dove non batte il sole ftohesira f.

Fronte ballëtë n. *a fronte a fronte* mballa, mballa; mballëfaqe *a fronte scoverta.*

Frontiera sogjia, meterizi.

Frutto pema; *frutici* driza, drica.

Frutto del latte della mandria bullmetitë.

Fuga të ikuritë; *fugore* përzë.

Fuggire ik, ikurë.

Fuggire altrove mtonj, mtuarë.

Fulminare bumbellonj, fërfulonj, furfulis.

Fulmine, saetta rrufeja, rrefej.

Fumare timonj -uarë -onem; kapnis -isurë -isem; *fumo* kapnoi, timi -it m

Funzione, solennità rënga f.

Fuori jashta, *fuorché* jashtë veçe *il di fuori* i përjashtshmi, i përjashtmi.

[63] [— vllaj vëlazeria

Fuor di mente, stordito i hutuemi.

Fuor d'opinione mē atej së kujtuemitë.

Furore menia, *furioso* i menijshimi, i këmbiemi *frettoloso* i ngutçimi.

Furiosamente menijshim.

Furto kusaria, të vjedhuritë.

Furtivo i tinezshimi.

Furtivamente tinezisht, kuserisht.

Fuso da filare boshti -it.

Fusile i shkrieshimi, i shkrieri, i losuri.

Fuscina da pescare fushnjara f.

Futuro çë të jetë, çë kā vinjë, çë kā përtardhurë; *mi piace più* i mo ardhuri e i për t'ardhurë.

G

Gabbia kafasi, shkëmbezë[64].

Gabella, dazio zarina.

Galla da tingere mazia f.

Gallina pula; *biocca* hjoka.

Gallo gjeli -it m.

Gamba kofsha f. *osso lungo della gamba* kersia, kersilli.

Gambetto, pedicino di frutti bishti.

Gambiera, armatura di piè çizma f.

Ganga, mola dhëmballa f.

Gara zeli; *gareggiare* zeleps.

Garzone rrogetari.

Gattigliare gutulisë -isurë -isem.

Gatto maçi m. maçeja f;

Gattarello *sic.* maçiurri, maçthi; maçiurrja f.

Gaudio gazi, gazemendi -it m.

Gelare merdhif -ifurë -ifem.

Gelamento të merdhifuritë n.

Gelata brima.

Gelatina pikteja f.

Gelosia di finestra kafasi.

Geloso i zëllshimi, i zellishimi.

[64] /schëmbazë\

Gelo akulli -it m.

Gemello binoshi -it m.

Gemere gjëmonj -uarë; *gemito* ghjëma f. vaj, vajtonj *gemere*.

Gemma guri i pākmuemi.

Generare lënj -lerë -lehem.

Generazione të lëmitë; *schiatta* fisi, brenzīt -it m. fara. f.

Genitore lesi; *genitrice* lëshja f.

Genere umano fisi i njerit; fara e njerzëvetë[65]; dora e njeriutë.

Geno, genere dora f.

Generoso trimi, zëmeruami.

Generosità trimeria, zëmera f.

Gengiva di denti xinxifi -it m.

Gennaro mese kallendori.

Gente gjindja f.

Gentile i pāfeu.

Gentilezza, cortesia njerezia.

Gentile njerezishimi.

Gentil'uomo bujari, bujureshia f.

Gerarchia rrjesti -it m. e bubuqeja.

Germoglio trishkeja f. rraskalli m. mugulli; delisemi të bijmitë n.

Germogliare mugullonj -uarë -onem; *della semenza* bīnjë, bijturë, bihem; shtie, ndërshienj -shierë shihem.

Gesso gisi; *sic.* jipsi.

Gettare, lanciare hit -iturë -item.

Gettare vedi buttare

Ghiacciare kullonjë -uarë -onem.

Ghiaccio akulli. m.

Ghianda, frutto ed albero lëndja f.

Ghiomero lëmshi.

Ghiotto, goloso grikesi, griktori, haepiesi.

Ghiottoneria griksia, haepieja f.

[65] |— gh| gnierzëvetë

Ghirlanda kurora luleshë, n ë tufë lule.

Già tas, *pò*; *giacchè* pse.

Giacobbe, Giacomo Jaku - u: m.

Giallo i verdhë; *giallezza* të verdhëtë; *farsi giallo* verdhem -erdhurë *da* verdh.

Giardino kopështi, perivoli.

Giamberghino xhup.[66]

Giardiniero kopështori, perivolari.

Giarra qupa f.

Ginocchio gjuri pl. gjunjëtë.

Giocare los, luanj, luarë.

Gioco lodra, lodertia f. *giocondo*

Giocondità gazemendi -it m. gëzueshimi.

Giogo zgjedha f. zigoi; zigua m.

Gioello della donna nalçi.

Gioja, allegrezza gazimi, gazemendi.

Gioglio erba argjëra f.

Gioire lodronj, gëzonem.

Gioncata shtalpa f. *sic.* shtalptë n. shtalpi.

Gionco ragosi, brezla *sic.*

Giorgi[o] Gjergji *sic. pure* dhedhia.

Giorno dita f. *solenne* e madhe; *di giorno* ditënë; *di notte* natënë; *giornale* i përditçimi i përditçmi; *domenica* e diellja; *lunedì* e hënja; *martedì* e martja; *mercordì* e merkurja; *giovedì* e enjëta, e enjëtja; *venerdì* e[67] prëntja; *sabato dì* e shëtundja; *giorno lavorante* dita punëtore, e levrueme.

Giovare vëjenj, ndih; *giovamento* të vëjemitë.

Giovane i riu, e reja; trimi, trimirī, trimaraqi; *sic. gioventù* trimeria f. *esser giovine, mandar fuori i primi peli* rrinj -iturë -item.

Giovenca mstierra f. demi *giovenco.*

Girare rrethonj; *giro* rrethi, rrethimi; *in giro* me rrethim.

[66] \giamberghino giup/ [67] [-- të / e]

Girar in torno njironj -uarë -onem.

Gittare a terra ndënj; shtronj.

Giù posht, pjetë posht, peshtjerrë.

Giudicare gjukonj -uarë, -uam -onem.

Giudicato officio gjukatia f.

Giudice gjukatesi, gjukuesi; pirgu[68].

Giudizio gjukimi.

Giugiola frutto murrizi.

Giugno qershori -it m.

Giulio korriku -ut m.

Giumenta pela f.

Giuntura gjimëtira f.

Giocatore lodërtari.

Giuramento beja f.

Giurare bënj bë.

Giuridisdizione të prekuitë n. pushtetja f.

Giustamente *sic.* drejt me ligjë.

Giustizia e drejta f.

Giustizia, magistrato gjuqi -it m.

Giusto i dërejti; e dërejta; të dërejtitë.

Giustificare ndreq -equrë -eqem.

Giustificatore ndëreqesi m.

Gloria ngushellimi. *sic.* dhoksa.

Glorificare ngushellonj; *sic.* dhoksias -asurë -asem.

Gnocchi dromëzatë *da* dromëza f.

Gobbo i ngërmuemi; i kërrusuri. *sic* i kërrusmi.

Goccia pika f. çika f.

Gocciolare pikonj; çikonj; e çikinj; çik.

Godere gëzonj; *sic.* trashgonj.

Gofforia horjatja f.

Goffo i trashi; horjati.

Gola parte del collo grika, fiti m.

Gola, vizio grikësia.

Goloso grikuesi, grikëtori, grikëtore f. *canna della gola* gromjazi.

Golera zardani o zardëni m.

[68] /pirgu/

Gomma lota e lisit.

Gonfiare frīnj -ijturë -ihem; ēnj, ëjturë, ëhem; *gonfiatura* të ëjturitë të frimit ë *pane gonfio sic.* bukë e ajme *da* ēnj *ed* ānj, ajturë, ahem.

Gonna vesta guna f. qurdheja f.

Gorgo d'acqua lugu m.

Gotta, malcaduco pika f. betajea f.

Gotto qelqi.

Governare ruanj, kulendris *sic.* qevarris.

Governatore qefalia m. ruesi, ronjesi.

Governo ronja f. *da* ruanj.

Gozzo gusha f.

Gradella skara f.

Graffiare con unghie grëvisht -ishturë - ishtem.

Gramigna grami, krisëlia f.

Granato shega f.

Grande i madhi, e madhja, të madhëtë.

Grandezza madhia f. të madhëtë n.

Grandine breshëri m.

Granchio gaforeia f.

Granello koqeja f.

Grano, frumento gruri; *sic* drithëtë n.

Graspo[69] rrembi; *graspo piccolo, cioè parte del graspo* veshi i rrushit.

Grassezza të majmitë n.

Grasso i majmi, sonxhia djamëtë n.

Grazia hiri; *di grazia* lutem *sic.* vore.

Grazioso i hjeshmi, i pëlqieshmi.

Graziosamente hjeshim, me hjē.

Gratitudine të njohuritë n.

Grato i njohuri.

Grattare kruanj -uajturë - uhem *sic.* skatanis.

Grattacascio kruaza f.

Gravare rëndonj -uarë - onem.

Grave i rëndi; *grave maturo* i urti.

[69] [= grappo]

Gravezza barra; të rëndësuamitë.

Gravida donna e mborsura[70], e ngarkuamja; barseja *delle bestie* e plotja, plota.

Gravidanza barreria f. ngarkimi m.

Gravità, autorità të madhëtë; pushtetja f.

Greco gërkiu -ut m. gërkia f.

Grecia Gërkia f. *alla greca* gërkisht.

Grega di grano duoi -it m.

Grembo, seno preheri, gjiu, gjiri m.

Gridare, contrastare qartonj; bërtes, brita, briturë; thërres, thirra, thirrë e thirrurë, thirrem e thërritem.

Grido qarta f. fritma, thirma f. zëri -it m. *Grido di pianto* gjëmeja f. *sussurro di qualsivoglia cosa* niterima f. *grido di mare* voshetimi -it m.

Grillo animale karkaleci -it m. kacadreni -it m. *grillo che mangia le biade* vrugu -ut m.

Griscio i thinjmi *sic.* i thimi, e thimja.

Grondaggia del tetto delle case streha f.

Groppa vitheja f.

Groppiera ndënëbishteja f.

Groppo neu -ut m. nie, nieja f.

Gropposo niesi -it m. *gropposa* nenjesa f.

Grossalmente trashisht.

Grossezza të trashëtë n.

Grosso i trashi, e trasha, të trashëtë n.

Grossolano, balordo, sciocco i hutuemi, i ndërlosimi.

Grotta spella f.

Grue uccello kërrila f.

Grugno hunda f.

Guadagnare dobit -iturë -item; gadhanjenj -ierë -onem.

Guadagno gjëja tëperë, dobia f.

[70] [embosaj e mborsura

Guai, lamenti vāj -it m.

Guainella de'legumi lluvia f.

Guajare, piangere come i fanciulli qānj -arë.

Guancia, gota falqinja f.

Guanciata shcplaka.

Guardare, vedere dhodit -iturë -item; shikonj -uarë.

Guardar fisso, osservare kehir, kehirinj, kehirurë.

Guardare, conservare ruanj -uajturë -uhem.

Guardia di notte straza f. sogjia f.

Guardiano ruesi, strazetari, sogjetari m.

Guardiano di campi ponderu -ut m. zagati -it m. *Guardiano di porta* deretari -it m. *Guardiano di armenti* çobari -it m.

Guarnello, veste di donna celona, gorraçeja f.

Guarnigione di veste zitaniku -ut m. kajtani -it m.

Gustare çart, çartinj, rreronj, shprish.

Guercio i shtrëmeri, e shtrëmera.

Guerra lufta f. amahi m.

Guerreggiare luftonj -uarë.

Guerriero luftetari, steketari m.

Guidare sjell, sjellë, sillem.

Guarnazione mbështeçë.[71]

Gustare, assaggiare kërkonj -uarë -onem.

Gusto, il gustare kërkimi -it m.

Gusto, diletto kenaqia f. ënda f.

Gustoso, dilettevole i shishimi, i përkënaqshimi -it.

Gusto inesplicabile shija e pāmasë f.

[71] \guarnazione mbëschiezë/



Leksiko, f. 79

H

Habile i vejeishimi -it m.

Habiltà të vejemitë n.

Esser abile ed atto stenem, u stena, stenurë.

Habitacolo, habitazione shatoreja f.

Habitante nel luogo, dove nashesi, vendesi -it m.

Habitare jes, mbeta, mbeturë, gjellinj -ijta -ijturë e gjellinj.

Habitazione shtëpia f. ntenja f.

Habito, qualità mendira f. vesi -it m.

Habito, veste petku m. veshja f. e veshura f.

Habito zakoni -it m. *uso.*

Hamo da pescare grepi -it m.

Hasta purteka f. *lancia* patershara f.

Havere kam, pata, pasurë e pasë, ka kem.

Haver bisogno kam nevojë, kam zī.

Hebreo jevreu, jevreisht *in ebreo.*

Heddomada java f.

Heddomadario javtari m. javtareja f.

Hemisfero faqeja e dheut.

Hellera urdhi -it m.

Herba bari -it m.

Herba da cavalli kasëla f.

Herbe domestiche da mangiare lakeratë pl. f.

Herede rresmi, rresmetari.

Heredità rresmja f.

Hereditore hinj ndë bjerī

Hereticare

Heretico

Heresia

Hernia të kuputuritë, të dakuemitë n.

Hernioso i dukuemi, i këputuri. *I'ursi l'ernia* kuputem -uturë, *da* këput, dekanem, dekuarë *da* dekonj.

Hieri dje; *avanti di heri* parëdjei *sic.* njëditëzë, *di heri, esterno* i djeshimi.

Idropico mbarkanjosmi.

Hieri sera prëmë, *il di jer sera* i mbrëmshimi.

Hipocrisia shemegjia f.

Hipocrito sherregjori, sherregjuesi, i stijmi m.

Historia kallezimi m. *Historia di santi* jeta e shejtravet.

Hoggi sod *sic.* sot, këtë ditë.

Hodierno i sodçimi; *sic.* i sotçimi.

Homicida mizori, gjakesori m.

Homicidio mizira f. gjakesia f.

Honestamente ndërshim.

Honestà nderja f.

Honesto i ndërmi; i ndershimi *honorevole.*

Honorare ndër -erturë -erem; nderonj -uarë.

Honore nderi -it m.

Hora, adesso tashti, tash, nani; *hor hora* pak isht; paretani *sic.* parthani; *per tempo* heret; *hor hora in questopunto* njëment; *hora* koha f. hora f.

Horribile, horrendo i shembtuemi, i tramenueshimi, i tremerueshimi, i tmerueshimi.

Horrore, terror all'improviso zmesa f.

Horsù po.

Horto kopështi -it m.

Hortolano kopështari, kopështarja f. e kopshtetori m.

Hostia

Hosteria konaku -ut m.

Hoste konakeja f.

Humanamente njerezisht.

Humanità njerezia f.

Humano i njerezishimi.

Humettare notis -isurë -isem.

Humidire lag -agurë e -agëtë -agem.

Humido, acquoso i ueshmi, i lageti.

Humettato notisurë.

Humidità lagësira f. ujesimi -it m.

Humidità, qualità fisica të njomëtë -it n.

Humile i prunjeti, i përvushimi; *sic.* i prultimi.

Humilmente përvushim, ultë, prultë.

Humiltà të prunjëtë n. të përvutitë, të prunjintë -it n.

Humiliare prūnj, prunjinj; *sic.* prul -unjurë -unjem; përvē -vënë, përvëhem.

Humore avulli -it m.

Huomo njeriu -ut m. njeri -it m.

Huomo da niente njeri pā vejeshim; *sic.* mosgjënjeri e asgjënjeri.



Leksiko, f. 101

I

Iddio Hī -īt, Zotinë, Perëndia m.

Idea shëmbeolltira.f.

Identificare bënj një.

Idolo

Ignobile horjati -it m. horjatja f.

Ignobiltà horjatja -isë f.

Ignominia mbarreja f. thuni, thuneja f. thunia f. *ignominioso* i dunuami.

Ignorantemente me të pādituritë.

Ignorante i pādituri; të pādituritë *ignoranza.*

Illecito i pāudhi -it m. i mallkuemi, i pāhjei -it.

Illecitamente për thunë, pāligjë.

Illuminare ndrit -iturë -item; shkrep -epurë.

Illuminazione të shkrepuritë, të ndrituritë.

Illustrare ndrit.

Illustre, nobile i ndritçmi, i ndritmi; *molto illustre* fort i ndritçmi, *illustrissimo* shumë i ndritçmi.

Illustre, famoso, molto chiaro i kthielleti.

Immaginarsi, credersi kam besë, kujtonj; *sic.* llojas.

Immagine, similitudine shëmbelltira f.

Imbattersi, trovarsi a caso ndodh -odhure, ndodhem.

Imbecille i lodheti; të lodhetë *imbecillità.*

Imbellettare ngjenj -ieturë -ihem.

Imboschire bënj pīll.

Imbrattare pegānj -ajturë -ahem; palavonj.

Imbrattare, ungere lienj -iejturë, lihem; përlienj -iejturë.

Imbrattar in torno përbalt -alturë -altem. përqork -arkurë -arkem.

Imbrattamento ndira, të pegāmitë n.

Imbrattato i pālavuemi, i shkriemi.

Imbriacare dënj -ejturë -ehem.

Imbriachezza të dëmitë n.

Imbrogliare, intricare ngateronj -uarë -onem; mbështiell -ellë -illem.

Imitare ndjek -ekurë -ekem; ndoqa *pret.*

Imbroglione ngateruesi -it m.

Imitazione të ndjekuritë n.

Immacolato i kulluemi, *la Vergine Maria Immacolata* Virgjëra Mrī e Kulluemja[72].

Immaturo i papjekuri. *sic* i pābëri.

Immagine, ritratto të dukuritë.[73]

Immediatamente ndë ças.

Immenso i madhi, e madhja, i pāumashi -it m.

Immobile i pāluetshimi, i pālekunturë, i slekunturi.

Immobilità të pālekunturitë, të pāluejturitë.

Immortale i pāvdekuri, i pāmorti.

Immortalità pāvdekeria, ameshimi -it.

Immutabile i pāndërrueshimi.

Immutabilità të pāndërruemitë n.

Impacciarsi hinj- ijturë -ihem.

Impadronire zoteronj -uarë -onem; dobit.

Impalar vigne o altro kūronj -uarë -onem.

Impallidirsi zbēnj, u zbejta, u zbeva, zbërë.

[72] |— pa|culuemia

[73] \immagine, ritratto të δδucurit/

Imparare xē̈, zē̈, xënë, zënë.

Impareggiabile i pāshoku -ut m.

Impassolire resh -eshurë -eshem; stofidhos -osurë -osem; rrefis -isurë -isem.

Impassolito resheti, refiksuri, i stofidhosmi.

Impastare mbrum -umurë -umem; gjesh.

Impaziente i pādurueshëm.

Impazienza të pādurueshmitë n.

Impaurire trëmp -ëmburë -ëmbem; drēronj.

Impazzire lënesonj -uarë -onem.

Impazzirsi mirrem, marrë, lihem lënë.

Impeccabile i pāmkati.

Impedire, proibire reshtë -eshturë -eshtem.

Impedire la strada mbërshell; *impedimento* të reshturitë, të mbajturitë të nxënëtë, të pēnguemitë n.

Impedocchiare morrit -iturë -item; përmorr, përmorrë, përmorrem.

Impegnare vē̈ penk, pēngonj -uarë -onem.

Impenetrabile i pādebertueshimi.

Impensatamente pākujtueshim.

Imperatore perandori -it m. mbereti, perendia m.

Imperatrice perendesha f.

Imperio perendia.

Impeto ushtimi *di vento, d'acqua.*

Impetuoso merishimi, rrembieshimi.

Impetrire nguronj -uarë -onem; nguringj.

Impiagare llavos -osurë -osm e -osem; vëronj.

Impiccare vier, vjerrë, virem.

Impicciolire vogëlonj -uarë -onem.

Impiegarsi nxihem, nxënë *sic.* mblonem.

Impietà të pādashuritë, të pādhimburitë.

Impio i pādashuri.

Impigrire mënonj -uarë -uam, mënonem[74]; përtes -esurë -esem, *part. anche* përtjerë.

Impiobare plumbonj -uarë -onem.

Impingere, attaccarsi ngjit -iturë -item.

Implacabile i pābuti.

Impolverare përpluhuronj -uarë -onem.

Imporre, commettere porosis -isurë -isem.

Importare, appartenere përket, përnket.

Importante, di premura i rëndi.

Importuno e merzitshimi, i mshueshimi.

Importuno, fuori di tempo jashtkohi.

Impresa dobia f.

Impostura çpifa, shpifa f.

Impossibile i zmunë, i zmunduri.

Impoverire vobegonj, vobegzonj.

Imprecare nëmë, nëmurë, nëmem.

Imprecazione nëmë f.

Imprestare huanj -uajturë -uhem.

Imprestarsi marr hua, huazë

Imprestatore huasi -it m.

Imprimere ngul -ulurë -ulem.

Imprimere, stampare udheninj, udhenurë, udhenem.

Improviso i pākujtuam; *all'improvviso* pāpriturë.

Imprudente i pāurti, e pāurtja.

Imprudentemente paurtë, lënërisht, pā urtësi[75]

Imputazione, calunnia zçpifa f.

Imputare, attribuire shtie, ngjej, çpif -isurë.

In *prep.* mbë, mbi, mi, ndë.

Inagire thartonj -uarë -onem.

Inalborare ngul -ulurë -ulem.

Inalzare nçonj, ngrinj, lartësonj.

[74] | - mnë] mënonem [75] /lënëriset, paa urtësii\

Inanzi përpara; *inanzichè* përpara se e çë.

Inargomentare rgjëtonj -uarë -uam -onem.

Inaprire idheronj -uarë -onem.

Incalzare nxit -iturë -item.

Incaminarsi ec, ecurë; shkonj udhësë.

Incantare shtrigetonj, magjeps -epsurë -epsem.

Incantesimo shtrigetia; magjia f.

Incantatore shtrigu.

Incarnare misheronj -uarë -onem.

Incarnazione të mishruemitë n.

Incastrare kurmezonj -uarë -onem.

Incavare korit, koritinj -iturë -item, gërrienj *a legni, sassi.*

Incavar terra nzier, rremonj.

Incauto i pākujtuami.

Incendere djeg -egurë, digjem.

Incendio të djeguritë n.

Incenerire bënj hī.

Incensare njemonj -uarë -onem; thimjatis -isurë -isem.

Incenso njemi, livani.

Incensiero thimjatoi -it m.

Incerare dillonj -uarë -onem.

Incessantemente gjithëmoti; pā pushuarë.

Incessante pā monë kurraj.

Inciampare skondaps -apsurë -apsem; përpjek.

Inchinarsi pushonj -ulem.

Inchinare prunjinj, prunjurë -unjinj.

Incirca afërë.

Inchiodare gozhdonj -uarë -onem m.; *in croce* mberthenj -jerë -enem.

Inchiostro mireqepi -it m.

Incitamento ndersimi -it m.

Incitare ndersenj -ersierë -senem.

Incivile, rustico i pānder-shimi.

Incollare ngjit -iturë -item.

Incombenza, ufficio rënga f.

Incominciare zē fill; nis -isurë -isem.

Incomodare mshonj, urrenj.

Incomodo trazimi m. merzita f.

In compagnia bashkë.

Incomprensibile i pāpashimi; i pāmarrëvesht.

Incontinenza të pāpërkuermitë.

Incontinente i papërkuermi.

Incontrare pjek -ekurë -iqem; përpjek.

Incorrere scomunica bie ndë mallkuemitë.

Incorrotto, puro, non guasto i pāçarturi.

Incorrotto, casto i deliri; e delirja.

Incorruttibile i pākalbiçimi.

In contesto, luogo ati.

Incredibile i pābeshimi -it m.

Incredulo i pābesi -it m.

Increspare rudh -udhurë -udhem.

Incudine kudheni -it m.

In dorno për të nkotë.

Indebolite lig -igurë -igem.

Indegno i pāvjeshimi, *indegnità* të pāvjeshimitë.

Indice dëftuesi.

Indicibile i pāmasi.

Indietro prapë, mbrapë.

Indigestione të pandreturitë. n.

Indigesto pandreturë.

Indiscreto i pārrëseu -ut m.

Indissolubile i pāzgjidhuri.

Individuo i pandāmi.

Indomito i pazbuti.

Indorare prëaronj -uarë -onem.

Indulgenza ndesa f.

Indurire thānj -ajturë -ahem; nguronj.

Indurre prīnj -īr, prihem.

Ineffabile i pākallezueshimi.

Inescusabile i palīshimi. .

Inestamento shërtimi.

Inestare shërtonj -uarë -onem.

Inestimabile i pāçmuemi.

Infamare zçpif -ifirë -ifem; ngjasinj -jesurë, ngjesem. .

Infamia, vituperio ngjesa f. zçpifa f. mbarreja f, dhunia; *infame* i dhunuami.

Infante fanciullo kërthini; djali.

Infanzia kërthinjeria f.

Infasciare ngjesh -eshurë -eshem.

Infarinare përmiell -ellurë, përmiellem.

Infedele i pāfeu, i pāfashimi.

Infedeltà të pafētë; *infedeltà* pafēshim.

Infelice i ngrati e ngratja.

Infelicità fatkeqi fatikeqi.

Infermarsi sëmūnem -undurë -uhem.

Infermarsi a lungo dorgjem.

Infermità sëmunda f.

Infermo i sëmundi; i sëmuri.

Inferno *sic.* pisa; *infernale* i pisësë.

Inferiore i përfundçimi, i përposhtshimi, i poshti.

Infiammare flakos, djeg, dhez.

Infiammazione të flakosuritë, të djeguritë.

Infilzare bënj varg, bërë vargt.

Infinità me të pasosurë, me të pazënë.

Infinito i pāzëni, i pāsosmi, i pāskanji, i pāsosuri; të pāsosismitë *infinità* n

Influire ngreh -ehurë -ehem.

Infuocare ndez -ezurë -ezem e -izem.

Infuocato i përzjarrshimi, i dhezuri, i flakosmi.

Informare jap fjalë; *informarsi* marr fjalë.

Infoscare urrēnj -ëjturë -ëhem.

Infoscato i urrëreti.

Infretta shpejt, ngutu; *in frotto* tufë tufë.

Infuso i dhënuri, i dhëni.

Ingagliardirsi marr fuqi.

Ingannatore dikeqi, shemegjuesi.

Inganno gënjimi, diekeqa.

Ingegno mendja f.

Ingentilire, nobilire fisnikonj.

Ingessare jipsonj.

Inginnocchiarsi bie mbë gjunjë, përgunjem -uarë *da* përgjunj.

Inghiottire përpinj -ijturë -ihem.

Ingiovanire përtërinj -ijturë -ihem.

In giù posht, poshtjerrë, përpjetë posht.

Ingiuria di parole e shajmja f. *di fatti* dhuna f.

Ingiuriare shānj -ajturë -ahem.

Ingiurar con fatti dhunonj.

Ingiuriare con nomi posticci çmonj -uarë.

Ingiurioso shasi, dhunuesi.

Ingiusto i pagjuqi[76].

Ingiustizia të pagjuqitë n. paligja.

Ingobbire shtrëmeronj, ngërrmonj, kërrus.

Ingrandire madhonj -uarë -onem.

Ingrassare mānj -ajturë, mahem.

Ingrassato i majmi.

Ingratitudine të pānjohuritë, të pādashuritë.

Ingrato i pānjohuri, i pādashuri.

Ingroppare nienj -iejturë, nihem.

Ingrossare trashinj, trashurë, trashem, ndrash.

Inhorridirsi, spaventasi all'improviso zmesem, zmeksem -eksurë, trëmbem.

Inhumano i pānjerezeshimi, i pānjereziu -ut.

Inimicamente armiqesisht[77].

Inimico armiku[78].

Inimicizia armiqëria, armiqësia.

Iniquo i keqi, i këqishi, i këqi, i bësikeqi.

Iniquità keqja f. *iniquamente* keq.

In mal'ora të marr dreqi.

Inamorarsi dua; *inamorato* i dashuri, i dashesi, duesi; të dashuritë *inamoramento.*

[76] [— të paghiuĸitë] [77] armi[— ch / ĸ]iesisct [78] [— inimicizia armich]

Innanzi paret, përpara.

Innocente i pākeqi.

Innocenzia të pākeqitë.

Innumerabile i pānjohuri.

Inombriare bënj hjē; *inombrato* i hjeshmi.

Inondare lundronj.

In ordine jam gatī; *in palese* shtruarë.

In questo mentre, frattanto ndë kaq, ndërë sā.

Inquietare trazonj; *inquetudine* trazimi.

Inquieto i pāpushuemi, i pāpapsuri[79].

Inquirere skiretonj, buberronj.

Inquisizione skiretima.

Inquisitore skiretuesi.

Insaccare vē ndë thes.

In salvamento shëndoshim.

Insanguinamento të përgjakuritë.

Insanguinare përgjak -akurë -akem.

Insaziabile i panginjshimi.

Insaziabilità të pā nginjuritë.

Insè ndë vetëhe.

In secreto tinezë, tinezisht.

Insegnare mbsonj -uarë -onem.

Insellare shalonj -uarë -onem.

Insensato i hutuemi, i këmbiemi.

Inseparabile i pāndashimi, i pāndami.

Insidiare përgjonj -uarë -onem, njimtonj.

Insidia njimtimi.

Insidiatore përgjuesi -it m.

Insieme bashkë, se bashku.

Insignorire pushtonj, dobit, zotronj.

Insipido i pāshishimi, i pashiei -it m.

In sino ndjerë.

Insolente i pāudhi, i leshuami.

Insognare ëndërrinj; shoh ndë ëndërrë.

[79] /i paa papsuri\

Insolenza të pāudhëtë, të pāleshuamitë n.

Insolito pazakoni -it m.

In somma nkrie.

Insopportabile i pādurueshimi.

Insordire shurdhonj -uarë -onem.

Insordito i shurdeti, i shurdhuri.

Inspessire brit -iturë -item.

Inspessito, folto briteti; *sic.* i rrasmi.

Inspirazione frima, drita f.

Instabile lekundeti.

Instabilità të lekunduritë.

Instante çasi -it m.

Instantaneo i çashimi, i çashmi.

Instanza të luturitë n.

Instigare nxit -iturë -item.

Instillare kullonj -uarë -onem.

Instrumento halata -së f.

Instrumento in generale alemijë -së f.

In su përpjetë, lart, përmal.

Insultare përleftonj -uarë -onem.

Insuperabile i pāpushtuemi.

Insuperbire madheshtonj -uarë -onem.

Insuperbito madheshtuemi.

Intagliare, scolpire këndis, dhendinj.

Intagliatore dhendesi, këndisesi.

Intaglio të dhenduritë, këndima f.

Intanto sā.

Intatto i tëri, i ungjiri *intiero.*

Intatto, puro i deliri.

Intatto, non toccato i pāprekuri.

Integrità, bontà e drejta f.

Integrità të tërëtë, të ungjuritë n.

Intelletto mendja f. *sic.* ndëlgimi -it.

Intellettivo i ndëlgueshimi.

Intelligenza të ndëlguemitë, vashtërimi.

Intemperanza të pāpërkuermitë n.

Intendente, savio ndëlguesi.

Intendere, capire ndëlgon; *udire* vashtëronj, gjegjem, marr vesh, marr veshtë.

Intenerire njom -omurë -onem.

Intenzione vulema f. *volontà.*

Intenzione, opinione hesapi -it m.

Intepidire vakinj, vak -akurë -akem.

Intercedere lutem *da* lus e lunj.

Intercessione të luturitë n.

Intercessore gojtari, gojtarja *intercessora.*

Interdire dalla chiesa shtie kishet.

Interno i përbrëndshimi.

Interiori del corpo zorrëtë, *vedi viscere.*

Interporre, framettere hinj qendratë.

Interpretare drogomanis -isurë -isem.

Interprete drogomani, drogomajtë pl.

Interpretazione drogomaria f. të kthjemitë, të shpështjellitë n.

Interrogare pienj, peves, pevet.

Interrogazione të piemitë n.

Interrompere il parlare bie ndë fjalëtë, dhienj fjalenë.

Intervallo vedi spazio.

Intessere ngjt e dredhedhurë -idhem.

